

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPALLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Përgjegjës Sektori, Drejtoria Juridike, Sektori Juridik&Ankimimet (Kategoria e pagës III-a).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër 34029/1, datë 28.09.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor (*ose të barazvlefshme me to*), në Shkencat Juridike. Diploma e nivelit Bachelor, duhet të jetë e të njëjtës fushë, (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësimi nga MAS*);;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Përgjegjësi i Sektorit ka për detyrë si më poshtë:

- Përgjegjësi i Sektorit varet direkt nga Drejtori Juridik.

Përgjegjësi i Sektorit ka këto detyra:

- a. Merr masa organizative për plotësimin e detyrave nga çdo specialist brenda planifikimit të detyrave të Drejtorisë Juridike;
- b. Evidenton problemet që dalin nga veprimtaria e përditëshme, si dhe çështjet e ndryshme që ngrihen gjatë veprimtarisë juridike, administrative, gjyqësore të

Institucionit, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon drejtorit rrugëzgjdhjet përkatëse;

- c. Kontrollon punën e përditshme të specialistëve në varësi, për plotësimin e detyrave që i janë ngarkuar;
- ç. Organizon administrimin e sistemit të informacionit dhe të statistikave për veprimtarinë e sektorit që mbulon;
- d. Bën vlerësime pune për nëpunësit dhe punonjësit e sektorit;
- dh. Kontrollon e verifikon zbatimin e ligjshmërisë në shkresat e hartuara
- e. Përgatit planet e punës vjetore dhe mujore, bën analize në nivel sektori, në zbatim të detyrave të përcaktuara nga Drejtori.

Dokumentat që aplikanti për Përgjegjës Sektori në Drejtorinë Juridike, Sektori Juridik&Ankimimet, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose të barazvlefshme me to në Shkenca Juridike dhe listë notash të noterizuara, *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS)*.
4. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);
5. Raport mjeko – ligjor;
6. Dëshmi penaliteti;

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 28.10.2022 ora 14:00.